Albania Investment Council
Improving Transparency and Investment Climate

# GJETJET E VROJTIMIT MBI DISA ASPEKTE TË KLIMËS SË INVESTIMEVE

MBLEDHJE E KËSHILLIT TË INVESTIMEVE

29 JANAR 2019

Perceptime & Përvoja

# PËRMBAJTJA

Albania Investment Council
Improving Transparency and Investment Climate

I. Hyrje

II. Profili i Bizneseve të Përgjigjura

III. Gjetje & Rekomandimeve

IV. Konkluzione

# I. HYRJE

## Objektivi i Anketës:

Evidentimi i ecurisë së shqetësimeve kryesore të biznesit të raportuara gjatë anketimeve të Sekretariatit 2015-2018, me fokus:

- Inspektimin Tatimor dhe Marrëdhëniet me Administratën Tatimore
- Informaliteti
- Rimbursimin e TVSH-së

## Metodologjia:

- Anketim bazuar në pyetësor standart: Kampioni 346 (2018), 146 (2017) 110 (2015)
- Anketa e plotësuar në mënyrë anonime online/Pyetësor i strukturuar
- Publikuar në Shqip dhe Anglisht në faqen e internetit të KI (Korrik-Shtator 2017, Korrik-Shtator 2018).
- Dërguar me e-mail në rreth 1.000 adresa biznesi, të zgjedhura në mënyrë rastësore nga databaza me 10.357 kompani, e krijuar nga burime zyrtare - QKB, DPT dhe databaza e konsultimeve të KI 2015-2018
- Kampioni u përgatit që të jetë përfaqësues në nivel kombëtar, në përputhje me shpërndarjen e bizneseve sipas sektorëve dhe rajoneve
- Kontaktuar me telefon rreth 1.000 biznese. 350 kompani iu përgjigjen anketës me një "response rate" prej 70%.
- Bashkëpunim me EPOKA për sensibilizim e bizneseve, sqarimin e pyetësorit dhe pyetjeve,
- Përpunim i të dhënave është realizuar nga Sekretariati i KI, duke përdorur SPSS

# II. PROFILI I BIZNESEVE TË PËRGJIGJURA









# II. GJETJE

# III. SHPËRNDARJA E KONTROLLEVE TATIMORE (2013-2018)







**Vihet re një shpërndarje e balancuar e tipologjisë së kontrolleve tatimore në 2018 krahasuar me 2015.**

**2017/2018 është rritur numri i kontrolleve tatimore dhe është ulur numri i inspektimeve tatimore.**

**Numri i inspektimeve në terren është reduktuar ndjeshëm për bizneset e mëdha në krahasim me 2015-2016, ndërkohë që kemi rritje të kontrolleve të plota.**

# III. Kontrolli Tatimor – sipas Sektorëve










**Mënyrat e kontrollit të përputhshmërisë me detyrimet fiskale janë diversifikuar sipas sektorëve**

**Tregti dhe indistri dominojnë vizitat fiskale**

**Shërbimet kanë shpërndarje të balancuar mes vizitave fiskale, kontrolleve dhe inspektimeve**

# III. Profesionalizmi i Inspektorit Tatimor & Qartësia e Raportit të Kontrollit 2015 – 2018







**Bizneset raportojnë përmirësim të profesionalizmit dhe qartësisë së dokumentacionit përgatitur nga inspektorët tatimorë në shkallë të mesatarizuar.**

**Ka ende hapësira për përmirësim, 64% e bizneseve mendojnë se inspektorët janë profesionalë.**

# III. Proçedura dhe Afatet për Rimbursimin e TVSH-së







**Gjatë 2018 përmirësimet e vëna re në rimbursimin e TVSH-së në 2017, nuk kanë qënë të qëndrueshme, rimbursimet vetëm mbas kontrolleve tatimore dhe ato që zgjatin më shumë se 30 ditë janë rritur në krahasim me vitin 2017.**

# III. A ka ndikuar rimbursimi i TVSH-së në vendimin e eksportuesve për të investuar?




**Vetëm 16% e kompanive eksportuese kanë deklaruar se vonesat në rimbursimin e TVSH-së kanë ndikuar vendimin e tyre për investime.**

**Kompanitë varen gjithnjë e më pak nga rimbursimi i TVSH-së në vendimmarrjen e tyre për investime.**

# III. Qartësia e Informacionit të ofruar për Tatimpaguesit




**Qartësia dhe saktësia e informimit i bizneseve nga autoritet tatimore ka ardhur në përmirësim të vazhdueshëm gjatë periudhës 2015-2018.**

# III. Dijeni e biznesit mbi sistemin e riskut dhe trajnime të ofruara nga AT







**Shkalla e informimit të bizneseve mbi sistemin e riskut është ulur gjatë 2018.**

**Shkalla e njohjes dhe trajnimit të biznesit në lidhje me sistemin e riskut në identifikimin e mos-përputhshmërisë ligjore ka ardhur në rënie.**

# III. Vlerësim mbi kënaqësinë nga shërbimet elektronike të tatimeve




**Bizneset raportojnë nivel kënaqësie në rritje në lidhje me shërbimet elektronike të tatimeve për vitin 2018, krahasimisht me 2015 dhe 2017.**

# III. A ndesheni me konkurrencë informale në sektorin ku operoni dhe si shfaqet?







Shkalla e informalitetit e perceptuar nga bizneset dhe e raportuar si konkurencë nga aktiviteti informal në sektor karakterizohet nga një trend negativ

Informaliteti është ulur me 14% në periudhën 2015-2018

Rënia e informalitetit karakterizohet nga ulje e evazionit fiskal

Praktikat korruptive mbeten një problem mjaft i ndjeshëm për biznesin

# III. A ka vetë biznesi një strategji për të ulur informalitetin?




**Vetëm 12.1% e bizneseve deklaruan në 2018 se kanë një strategji për të ulur aktivitetin ekonomik të pa formalizuar.**

**Ulja e informalitetit është reflektuar edhe në uljen e numrit të bizneseve që kanë strategji për formalizimin në 2018 krahasuar me 2015.**

# III. Apelimi Tatimor, Shtator 2017- Qershor 2018

A ka apeluar kompania juaj rezultatet e inspetimit tatimor?




A keni apeluar vendimin e inspektimit përmes një ankimimi administrativ?




Cili ishte autoriteti administrativ ku ju keni apeluar vendimin e inspektimit tatimor?




Vendimi mbi apelimin ishte në favor të kujt?




Si do ta vlerësonit nivelin e marrëveshjes me vendimin e apelimit?




E keni çuar vendimin e ankimimit në gjykatën administrative?




**Vetëm 16% e kompanive kanë apeluar vendimin e inspektimit tatimor; nga ata që kanë apeluar vendimin, 89% e kanë dërguar vendimin për ndjekje administrative tek Drejtoria e Apelimit (93% të rasteve) ose KSHAT (7% të rasteve).**

**Vendimet e Apelimit në 71% të rasteve kanë qenë në favor të administratës tatimore; 61% e kompanive nuk janë dakord me vendimin; nga ato që nuk janë dakord vetëm 35% i drejtohen gjykatës.**

# III. Faktorët që nxisin Informalitet – Anketimi 2018




**Faktorët që nxisin informalitet:** Konkurrenca e padrejtë, praktikat korruptive të biznesit, barra fiskale e shkaktuar edhe nga rritja e taksave dhe tarifave lokale.

# IV. KONKLUZIONE

Albania Investment Council
Improving Transparency and Investment Climate

**Gjatë 2018, krahasuar me 2015, mekanizmat e sigurimit të përputhshmërisë më detyrimet e administrimit fiskal janë balancuar dhe përshtatur me specifikat e sektorëve dhe nivelin e riskut**

**Përmirësimet e vëna re gjatë 2015 në sistemin e fiskut duhet t'u sigurohet qëndrueshmëria nëpërmjet përmirësimit të qëndrueshëm në trend te profesionalizmit të inspektorëve dhe komunikimit me biznesin**

**Informaliteti pas shumë përpjekjesh dhe politikave qeveritare ka hyrë në një trend rënës, ky është një momentum pozitiv për forcimin e mekanizmave të formalizimit të ekonomisë**

**Praktikat korruptive dhe barra fiskale, sidomos rritja e barrës fiskale në nivel lokal ngelen shqetësime për biznesin në përpjekje për formalizim**

**Komunikimi me biznesin dhe informimi i tij në KOHË mbi ndryshimet proceduriale DHE ligjore SHUME DINAMIKE se fundmi mbetet faktor përcaktues në përmirësimin e klimës së investimeve dhe të të bërit biznes**

**Ndërkohë që sipas MF është rritur niveli i rimbursimit të TVSH-së në vlerë, ritmi i rimbursimit të kompanive të vogla perceptohet në ulje në 2018? Ndoshta është një moment për të reflektuar mbi balancën midis rimbursimit të projekteve të mëdha, raportit me kërkesat dhe nivelin e rimbursimit të ndërmarrjeve të vogla?**

# FALEMINDERIT !

www.investment.com.al